REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 26.03 .2026

Nr. 466/3 prot.

# PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
## date 25 .03 .2026

Në mbështetje të ligjit nr.**139/2015**, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim te vendimit të kryesisë së këshillit nr.2 datë 17.03.2026, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë u zhvillua me datën **25 .03 .2026** ,ora **13-30** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite: :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.02.2026
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2026.
3. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shkurt** 2026.
4. Projekt-vendim : "Për miratimin e anekseve të monitorimit të Buxhetit ,12 mujori i vitit 2025"
5. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë " Z. Gjon Berisha.
6. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë " Z. Kadri Morina.
7. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë " Imam Adem Ademi.
8. Projekt-vendim : "Për_ miratimin e krijimit të këshillit vendor për sigurinë publike në Bashkinë Pukë"
9. Për lirimin nga detyra e sekretarit të Këshillit Bashkiak , i cili përfundon marrëdhëniet e punës me datë 30 Prill 2026, pasi del në pension .

10.Për zgjedhjen e sekretarit të ri të këshillit bashkiak, i cili fillon marrëdhëniet e punës me datë 01 Maj 2026.

11.Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Ferit Ringaj , zv/ kryetari i Bashkise, Lavdie Terbuni, pergjegjese e zyres sociale , Sokol Gjoni , drejtor i burimeve njerezore, Fiqirete Latifi. Drejtore e Finances,

Mbledhja filloi ne oren 13:30 . Jane prezent ne mbledhje 11 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka hapi mbledhjen dhe prezantoi projekt-rendin e dites te miratuar nga kryesia.

Pas diskutimit te anetareve, u hodh ne votim dhe u miratua rendi i dites , me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

1. Mbledhja vijoi me **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 11.02 .2026**

U hodh ne votim dhe u miratua **procesverbali i mbledhjes së dates 11 .02.2026** me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2026.

**Pyetje : Gj. Gjoka : A ka patur ankesa, paksime?**

**Sqaron : Lavdie Terbuni**: Jo nuk ka patur ankesa dhe as paksim te numrit te familjeve.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2026, me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shkurt** 2026.

**Pyetje : Gj. Gjoka : A ka patur ankesa, paksime?**

**Sqaron : Lavdie Terbuni**: Jo nuk ka patur ankesa dhe as paksim te numrit te familjeve.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shkurt** 2026 , me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

4. Projekt-vendim : "Për miratimin e anekseve të monitorimit të Buxhetit ,12 mujori i vitit 2025"

**Pyetje : Enver Sulejmani : Pse nuk jane realizuar 100% te gjitha zerat.**

**F. Latifi: ky fenomen eshte vetem te shpenzimet sektoriale, nuk jane 100%.**

**Sqaron :** Fiqirete Latifi jane prezantuar sipas tabelave standarte dhe udhezimeve perkatese. Eshte proces standart.

U hodh ne votim dhe u miratuan anekset e monitorimit të Buxhetit ,12 mujori i vitit 2025" me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

5. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë " Z. Gjon Berisha.

Gjon Gjoka: Prezantoi motivacionin e dhenies se titullit "Qytetar Nderi" i Bashkise Puke.

Pyetje : s'ka

Sqaron : Sokol Gjoni prezantoi pjese nga kontributi i tij nder vite.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Gjon Berisha , me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

6. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë "

Z. Kadri Morina.

Gjon Gjoka : Prezantoi motivacionin e dhenies se titullit "Qytetar Nderi" i Bashkise Puke.

Pyetje : s'ka

Sqaron : Sokol Gjoni prezantoi pjese nga kontributi i tij nder vite .

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Kadri Morina , me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

7. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë " Imam Adem Ademi.

Gjon Gjoka: Prezantoi motivacionin e dhenies se titullit "Qytetar Nderi" i Bashkise Puke.

Pyetje : s'ka

Sqaron : Sokol Gjoni prezantoi pjese nga kontruti i tij, gjate viteve , qe punoi dhe kontribuoj ne Puke.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë Imam Adem Ademi , me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

8. Projekt-vendim : "Për miratimin e krijimit të këshillit vendor për sigurinë publike në Bashkinë Pukë"

Pyetje : Gj. Gjoka : Çfare eshte ky komision? Pse eshte ngritur?

Sqaron : Sokol Gjoni sakteson udhezimin e qeverise dhe anen pozitive qe ka per rritjen e sigurise, dhe pergjegjeshmerise institucionale per sigurine duke patur perfshirje te gjere te institucioneve.

U hodh ne votim dhe u miratua krijimi i këshillit vendor për sigurinë publike në Bashkinë Pukë" , me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

9. Për lirimin nga detyra e sekretarit të Këshillit Bashkiak , i cili përfundon marrëdhëniet e punës me datë 30 Prill 2026, pasi del në pension .

Pyetje: ska

Sqaron Komisioni i mandateve : Keshilli ka menduar , qe ne periudhen tranzitore te pergatiten dokumentet per dorezim dhe te trajnohet sekretari i ri , duke kaluar dhe eksperiencen e sekretarit paraardhes.

Procesi i kalimit te funksionit dhe marredhenieve te punes do te sherbeje per mbarevajtjen e punes se Keshillit.

U hodh ne votim dhe u miratua lirimi nga detyra e sekretarit të Këshillit Bashkiak z. Hazbi Terbuni , i cili përfundon marrëdhëniet e punës me datë 30 Prill 2026, pasi del në pension , me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

**10.** Për zgjedhjen e sekretarit të ri të këshillit bashkiak, i cili fillon marrëdhëniet e punës me datë 01 Maj 2026.

Pyetje: Sh. Pemaj : A ka te interesuar per te qene sekretar keshilli?

Sqaron : Kryetari i keshillit Po eshte nje kandidate , me universitet, juridik, te tjere te interesuar nuk ka.

Paraqiti kandidaturen e te interesuarit , qe eshte Ndriçim Asllanaj. Lexoi kerkesen e paraqitur prej tij.

U kalua ne formimin e komisionit te votimit te perbere nga : Arben Gugaj , Aleksander Frroku dhe Besar Kuçi Komisioni zgjodhi Sekretar Arben Gugaj dhe kryetar Aleksander Frroku. Komisioni pergatiti fletet e votimit , te firmosura nga komisioni dhe filloi procesi i votimit.

Ne fund te procesit te votimit komisioni plotesoi procesverbalin e procesit te votimit . Moren pjese ne votim 11 keshilltare, Votuan pro kandidatit Ndriçim Asllanaj 10 ( dhjete ) keshilltar dhe 1( nje ) kunder.

Pas votimit te fshehte me vote nominale komisioni shpalli fitues me 10 vota pro dhe 1 vote kunder , 0 vota abstenime , pra u miratua zgjedhja e sekretarit të ri të këshillit bashkiak, i cili fillon marrëdhëniet e punës me datë 01 Maj 2026.

**11.** Te tjera.Kerkese e z. Mustaf Mehaj per lejimin e stervitjes se ekipit te femijeve per t'u stervitur ne ambjentet e klubit sportiv Terbuni.

Keshilli i shpreh dakord , po keshtu dhe zv/kryetari i Bashkise u angazhua per zgjidhjen e ketij problemi.

%

26

Enver Dulgjini

Gjon Gjokaj

Ndue Lalaj

Leze Kolaj

Dritan Asani

Shpresa Pemaj

ALFONS GJERGJAJ

Mesor Kuçi

Edmond Lala

Aleksandër Frroku

Sekretari i Këshillit
Hazbi Jeshuri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA